

INTERVISTË ME FAZLI HAJRIZIN

Mitrovicë | Data: 19 nëntor, 2024

Kohëzgjatja: 75 minuta

Të pranishëm:

- Fazli Hajrizi (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Adea Batusha (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Fazli falemnderit fillimisht që keni pranë me bisedë me neve. Ju keni lindë domethonë në vitin '49, ka qenë në kohë pas Luftës Dytë Botërore, ka qenë në kohë pak e fshtirë për neve si shqiptarë të Kosovës. A ju kujtohet kur keni qenë fëmijë si kanë qenë rrethanat, si ka jetë familja juaj, si jeni shkollë ju? A ka ndiku koha e [Aleksandër] Rankoviqit edhe në familjen, rrethin e juaj?

Fazli Hajrizi: Falemnderit për ftesën! Unë jam i lindur në fshatin Kotorr, Komuna e Skenderajt me 25. 11. '49. Në një familje të madhe diku mbi 35 antarë të familjes, prindër me fëmijë, me xhaxhallarët edhe jam shkollë aty katër vjet. Edhe mandej kemi vazhdu në Runik, Runiku osht një pesë-gjashtë kilometra në vijë ajrore kështu. Një rrugë e fshtirë nëpër male, nëpër përroje si të thuash. Po megjithatë kemi arritë ta kryjmë edhe tetë vjeçaren atje. Prindërit kryesisht, mendoj familja jonë kryesisht është marrë me blegtori edhe bujqësi. Edhe pse toka ishte shumë e ligë po megjithatë punohej.

Në atë fshat ku kishte diku rreth 35 shtëpi edhe shumica e prindërve, shumica e të rinjëve në periudhën e viteve '50-'60, për të ndihmuar familjen gjatë verës punonin kush në Bosnje, Trebinjë për shembull ose në Mal të Zi në Nikshiq apo gjeti. Për shembull baba im ka punuar thuja dymdhetë vjet atje. Sa e kom kry edhe shkollën fillore edhe tetë vjeçaren në Runikë. Domethonë ka qenë në jetë edhe në kohë mjaft e vështirë. Në Kotorr në mesin e viteve '50 është ndërtuar një objekt edhe ai i thjeshtë shumë. Përndryshe mësimi në fillim është mbajtur në oda, domethonë në shtëpi private.

Anita Susuri: A ju ka ra edhe juve?

Fazli Hajrizi: Jo, mua jo. Mirëpo, entuziazmi ose dëshira për të shkolluar ka qenë mjaft e madhe. Të them sinqerisht edhe pse ekzistonte njëfarë mentaliteti që ndoshta edhe nuk është mirë të shkollohen fëmijët. Po disa që kanë mbarue, qoftë këtu në Mitrovicë, qoftë në Tiranë në kusheri i yni Rrahim Gashi që e kom pas edhe mësues, vazhdimisht kanë senzibilizuar si të thuash në masë se shkollimi është e vetmja rrugë që na shpie kah drita, dituria edhe perspektiva jo vetë e familjes po edhe e kombit kështu.

Ai kuptohet i pat shkolluar fëmijët e tij, njëri ishte mësues në Runikë. I dyti Ibrahim Gashi që ma vonë u bë edhe doktor i shkencave matematikore, deri në vitin e tretë ka qenë në Beograd me Ejup Hamitin,

Skender Skenderin, me personalitete tjera. Mirëpo, meqë u burgos atje dihet çka dikun '58-tën u detyruan si të thuash të ikin në Shqipëri atje edhe kanë jetuar edhe eجتjnë pasardhësit po Ibrahim ka vdekë në vitin 2012. Ka qenë edhe sekretar në ambasadën e Sllovenisë në vitet '90-ta atëherë në kohën e demokracisë Shqipërisë e sende.

Ata kanë qenë si të thuash motivi unë kryesor që të vazhdojmë shkollën edhe pse ishim një të them të drejtën krejt krejt pesë-gjashtë fëmijë që e vazhdonim shkollimin jo veç të tetë vjeçares, mo të mesmen veç tek ma vonë kanë vazhduar domethonë unë kam qenë edhe vëllai im edhe një kusheri, domethonë tre kemi qenë ata që kemi vazhduar shkollën e mesme në fillim, në të vërtetë në mesin e viteve '60-të, unë në gjimnaz ndërsa ata në shkollë ekonomike edhe atë rrugë që e kemi bërë prej Kotorrit deri këtu ka qenë e pamundur se është shumë larg, po çdo javë ose dy javë është dashur të udhëtojmë për të ndërruar rrobat për të marr ndoshta edhe ushqime të ndryshme sende.

Po edhe në ato kushte shumë të vështira dëshira për të arritë kështu edhe për të fituar edhe dituri po njëkohësisht ndoshta edhe një vend pune, se se kemi mendu ne që do të studiojmë e do të bëhemi mësues nesër e do të arrijmë këtë e këtë. Po kryesore ka qenë të arrijmë të bëhemi mbështetës ose krah i familjes për ta ndihmuar financiarisht e kështu. Të them të drejtën ni punë të madhe ka bë edhe babai im i cili ka qenë i pashkolluar po autodidakt.

Ai ka mësuar kështu të lexoj e të mësoj në fillim me çirilicë se punoj gjatë në Mal të Zi, mirëpo kur erdh këtu edhe e filloj punën si mjeshtër në 'Kosovën' e Vushtrrisë, i merrte "Rilindjen" që i blenim ne çdo ditë i lexonte edhe aty ka mësuar. Bile shpesh hynim në dialog me të që i kapte gjanat shumë, shumë mirë. Po them kanë ndikuar shumë faktorë që ne në njëfarë mënyre të marrim njëfarë shtyese, kështu drejtim të mirë besoj edhe të arrijmë diçka.

Të them drejtën nuk duhet harrue sidomos nana kur shkoja nganjiherë brenda javës ose dy jave e gjeja xhemperin e përgaditur, se s'kishim edhe veshje si duhet. Po them në gjimnaz sa kam qenë, madje edhe në vitin e parë të studimeve '68 - '69, them sinqerisht me Sabri Hamitin e ni grup si të thuash studentësh kemi qenë të veshur keq. Madje me opinga të Pirotit, ato të llastikut e dini besoj. E tani erdhën ditë të mira. Ato deri në vitin '66 kanë qenë kohë me të vërtetë të vështira por ne shumë nuk i kemi kuptuar.

Ato i kanë përjetuar randë sidomos prindërit tanë, gjyshërit tanë, nënat e gjyshet tona, për arsye se shpesh, gati nuk ka pas ditë që vinin policët nga Runiku për të marr dikë për ta lidhur atje tek mollat, ka qenë një oborr te stacioni i policisë dhe aty si të thuash i gdhinte mëngjesi të lidhur për peme. Edhe të mërdhirë si të thush. Këto jo që na i kanë treguar po i kam përjetuar vet. I kam pa, kam qenë i ri po, njerëzit shkonin e i vizitonin dhe atëherë me ndodnjë peshqesh të vogël, ndonji vezë ose petulla kështu diçka. Më kujtohen këto gjana shumë mirë.

Edhe koha kur ra ose u shemb regjimi i Rankoviqit që ka qenë Ministër i Punëve të Brendshme, për shqiptarët ka qenë një frymëmarrje të them sinqerisht. Një frymëmarrje se bile frika edhe ai presioni psikik e fizik e gjitha ato sikur u zvogëluar, s'do të thotë që kanë pushuar ndonjëherë por megjithatë bile pak kështu. Ato shkolla që janë hapur në Drenicë, ose në Shalë ose në Dukagjin, ose Podgur ose në rrethin e Anamoravës, ose kudoqoftë që janë hapur në kohën e Shipnisë të lirë ose tokave të lirueme si i quanin përpara në kohën e okupacionit ose pushtimit fashist italian, Mitrovica mbeti si prefekturë me nënprefektura mbeti në kuadër të Gjermanisë. Me Vushtrrinë, Podujevën edhe Pazarin e Ri.

Edhe në Pazar të Ri janë hapur shkolla për shembull, kam lexuar kuptohet mësuesit si Hateme Shala ose Abdullah Zajmi që ka qenë profesor shumë i dinjitetshëm në Normale të Prishtinës edhe punëtor në Institutin Albanologjik e plotë e plotë të tjerë kështu. Mandej Bedri Gjinaj, Lina ose Paulina, Simon Shkrelin, me Halit Haxhën e plotë të tjerë. Po kështu edhe në Vushtrri, po kështu edhe në Podujevë. O mos të flasim për këtë pjesën që ishim nën sundimin ose nën pushtimin italian.

Domethonë nëse ka pasë një hapje të rrugës për perspektivën e arsimit tonë ka qenë në shkolla në vitet '41 - '44. Se ju e dini besoj në kohën e pushtimit Osman ka pasur ndonji mejtepe¹, ka pasur ndonji Ruzhdije² ose ato shkollat që janë më të ulëta, *ididadije*, *iptidaije* ku di unë, deri tek mejtepet e ndryshme që i kanë vazhduar fëmijët tanë, mendoj të rinjtë tanë e mandej kanë vazhduar në Shkup. Janë pregadit kryesisht si mësues të fesë, edhe nuk kanë qenë me një fjalë shkolla të mirëfillta kombëtare.

Ndërsa viti 1912 e kom fjalën për Kosovën kështu, viti 1912 e deri në vitin 1918, deri 1915 ka qenë poashtu një terror i ushtruar në mënyrën më të ulët, ku dihet ka pasur vrasje, ka pasur zhvendosje. Edhe shumë familje ishin vendosur nga Sanxhaku i Nishit nëpër këto hapësira edhe në rrethinën e Mitrovicës, kanë vazhduar si të thuash atë rrugëtimin deri në Turqi e gjetiu. Domethonë ka qenë një kohë shumë, shumë, shumë e vështirë.

Ardhja e pushtuesve austro-hungarezë sikur e kanë stabilizuar po në një periudhë shumë të shkurtër 1915-18 u hapën disa shkolla, është hapur edhe në Mitrovicë. Ndonji për shembull edhe në Zhabar, ose në Kushtovë ose në Broboniq, mendoj në Mitrovicë dhe këto tre-katër fshatra. Po me një vijim shumë të vogël të nxanësve, ato shkolla pastaj që u hapën pas vitit 1918 në kohën e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene ose si ta quaj Mbretëria Jugosllave si është qujt, të them të drejtën shkollat shqipe kanë qenë të gjitha të ndaluara. Aty-këtu ndonji nxanës ka vazhduar shkollën fillore ose të mesme, e kom fjalën për shqiptarët.

¹ Mejtepi, gjithashtu e quajnë edhe Meqtebe që d.m.th. vendi ku shkruajnë, shkolla. Meqtebe është një fjalë arabe që ka kuptim të dyfishtë: kuptimi i parë ishte emërtim i shkollës kurse kuptimi i dytë në rastet më të shpeshta kishte domethënien e shkollës fillore islame.

² Ruzhdia ose Ryzhdije ishte një shkollë e mesme osmane (progjimnaz osman) në kohën e Perandorisë Osmane e cila ka vepruar në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Këto institucione arsimore ishin themeluar me Ligjin e Arsimit të vitit 1869, të kohës së Tanzimatit.

Kështu që, shkollimi ka qenë në nivelin më të ulët. Edhe kjo periudhë që e përmenda ma herët që lidhej me jetën time, me kujtimet e mia të shkollimit edhe ajo ka qenë një kohë mjaft e vështirë me numër shumë të vogël të nxanësve të përfshirë. Sidomos në shkollimin e mesëm, e mos të flasim për shembull të lartin. Kur ka marr hov kjo, sigurisht në fillim të viteve '70, e sidomos në aprovimin e Kushtetutës së Kosovës 1974. Pak më herët hapjen e Universitetit të Prishtinës.

Dhe të gjitha këto në njëfarë mënyre ua kanë hapur rrugën demonstratat 1968-tën, kur kërkohej jo veç flamuri po edhe universiteti edhe njëfarë subjektiviteti pak më i lartë i Kosovës kështu e që mandej u përsëritën edhe '81-shën. Po që më vonë në të vërtetë na u kthye se duke menduar se do të ecën ajo faktikisht u degradua thuja gjithçka edhe administrata, edhe arsimi, edhe shëndetësia, edhe ekonomia edhe shumëçka tjetër.

Anita Susuri: Deshta me ju pyet për '68-tën që e përmendët, po më duket edhe ju keni qenë atëherë student në Prishtinë?

Fazli Hajrizi: Kom qenë student vajzë por po them sinqerisht nuk e kom ditë që do të mbahen ato. Kam qenë i ri edhe si duket janë mbajtur kështu si të thuash në fshehtësi. Kanë ditë vetëm organizatorët edhe ni pjesë e mirë kështu që ma vonë edhe janë inkuadruar. Tash ndoshta mos po e teproj kështu me sqarime po kishim festën, atëherë të 29 Nëntorit edhe unë pata shku në fshat edhe atje dëgjova që janë mbajtur demonstratat. Po e kanë pas efektin e vet.

Jam interesuar pastaj, kam dëgjuar prej shokëve të mi që kanë marr pjesë edhe bile disa kanë qenë të burgosur edhe të maltretum në atë kuptim. Po megjithatë ajo ka qenë një shtytje e madhe, një frymëzim i madh. Mu më kujtohet për shembull pak më herët, se edhe asaj i kanë paraprirë disa gjëra të lutem. Për shembull '68-tën në janar kam qenë nxanës në vitin e katërt edhe u shënuar 500 vjetori i vdekjes së Skënderbeut.

Po çfarë atmosfere ka qenë në gjimnaz, veç ata që e kanë pa dijnë me përshkrue edhe me tregue, shumë interesant. Se sigurisht nga ajo ngulfatje shumë vjeçare, sikur shpërtheu një diçka dhe vërtetë edhe ato pak poezi, pak vargje ose ato pak tinguj që i ndëgjonim në atë frymën kombëtare na ushqenin shpirtërisht dhe kështu ka qenë edhe kjo e vitit '68 që vërtetë i vuri ma merr mendja në vijë të mbarë plot gjëra kështu.

Anita Susuri: Po du me ju pyet ju si vendoset për fakultet, a ju ka përkrah familja për shembull financiarisht apo keni gjet punë?

Fazli Hajrizi: Në vitin e parë po, në vitin e parë meqenëse nuk mu dha as kredi e as bursë, e kam kaluar. Tash nuk e di nën fakultet ka qenë një barakë kështu ku rrinin ushtarët, besa përpara kishte shërbyer si shtallë e kuajve gjithashtu po e kishin adaptu edhe aty kemi ndejt e ma vonë janë ndërtu ato lart atje. Mirëpo, në vitin e dytë u bë mirë që fitova bursën. Ishte një ndihmesë shumë e madhe për

mua edhe si e kam mbaru vitin e dytë edhe e kom dhon gjuhën latine, po mendoj si landë. Si bursistë që kam qenë më pranuar në gjimnazin e Skenderajt ku kom punu tri vjet si arsimtar i gjuhës latine.

Ende i pa diplomuar po me një mundësi për të vazhdu studimet edhe besoni për çdo provim që kam dhanë kam dhonë në shpërblim me të holla, që ishte një motiv shtesë kështu. Ka qenë po thom në kohë që besoj ishte në rilindje për neve, mendoj për kombin tonë dhe për familjet tona kështu. E në '73 kur kam përfunduar studimet mandej kam shkuar ushtarak edhe kur jam kthyer në vitin e parë kam punuar në teknikë edhe jam kthyer aty ku kam qenë i pranuar para se të shkoj ushtarak se isha i pranuar kështu në gjimnaz.

Anita Susuri: E çka keni studiuar ju? Nuk na tregoj çka keni studiuar?

Fazli Hajrizi: Kam studiuar gjuhë dhe letërsi, të them të drejtën kam qenë i dobët në këto fushat e shkencës, po mendoj matematikë e fizikë e kimi e sende, kom punuar po e dija që jam larg shokëve të mi të cilët ishin shumë më të përgaditur, kisha një prirje kështu për letërsinë. Kisha dëshirë kështu për lexim edhe besoj diçka kom bo, kom arritur kështu.

Anita Susuri: A keni pas profesora në fakultet, çfarë profesora keni pas?

Fazli Hajrizi: Po të them sinqerisht kanë qenë shembuj kështu edhe si pedagog edhe si intelektual, po i përmend nëse e harroj ndonjerin më vjen keq po, Anton Çettën që na jipte letërsi të vjetër. Latif Berishën që na jipte romantizmin. Shefqet Pllanën që na jipte letërsi popullore, Mehdi Bardhin që na jipte fonetikë, Latif Mulakun që na jipte morfologji, Hasan Mekulin që na jipte letërsi botërore. Ai po thom sinqerisht ka qenë një njeri me diapazon të jashtëzakonshëm kështu, e njihte letërsinë jugosllave, botërore me një fjalë një intelektual kështu i kompletuar. Mandej Isak Shema e të tjerë kështu.

Anita Susuri: Ju tregoj që gjimnazin e keni përfunduar në Mitrovicë e në Prishtinë fakultetin, në këtë kohë kur keni qenë ju i ri, si kanë qenë këto dy qytete për shembull jeta kulturore, sociale si ka qenë atëherë?

Fazli Hajrizi: Të them sinqerisht, kur kam ardhur në gjimnaz në vitin e parë sikur nuk kam mujt me u gjet. Isha i ri dhe krejt preokupimi im ka qenë ta mbaja pak a shumë atë nivelin që kishe kisha arritur nga fillorja këtu me një sukses me një diçka dhe njëkohësisht kisha kujdes që mos të bëja ndonjë gabim. Për shembull një qortim i vogël në vitin e parë e kam fjalën në profesorit të gjuhës frengje se, "Të kom pa ty edhe ty", dy-tre nxanës në mesin e tyre edhe mua në korzo që unë edhe nuk e dija çka është korzoja edhe nuk e kisha kuptuar nocionin kuptimin e kësaj fjale edhe, "Nuk ban duhet të mësoni, duhet të kështu..."

Edhe të them të drejtën gjumi nuk më ka marr tanë natën se thojsha kom bo na gabim shumë, shumë të madh. Mirëpo, në vitin e dytë kur disa e përcillnin teatrin, këtu ka qenë. Në atë kohë ka qenë Ali

Ahmeti, ka qenë ky [Mikullovci Ademi](#). Ende këtu punonin, luanin pjesë të ndryshme. Nji që s'më kujtohet me mbiemrin Deva, e disa të tjerë kështu që kanë kalu pastaj...[në Prishtinë]. Bile disa pjesë edhe Melihate Qena kanë lujt këtu në Mitrovicë, i përgadisinin.

Jëta kulturore këtu ka qenë në nivel ndoshta më të lartë se në Prishtinë, se unë kam qenë pastaj në Prishtinë. Më ka ra me shku për ta pa ndonji shfaqje, po them sinqerisht ma shumë shkonim për të pa filma. Kanë qenë dy-tri kinema, ka pas edhe këtu. Po them edhe në fushën e sportit, edhe në fushën e muzikës, edhe në fushën e teatrit mendoj kështu. Mitrovica nëse nuk ka qenë ma e mirë se Prishtina e barabartë po.

Kështu në atë periudhë, ndërsa nga fillimi i viteve '70-ta e këndej faktikisht disa prej majave të kulturës, mendoj njerëzve të kulturës, sikur i tërhoqi Prishtina dhe atje shkuan dhe megjithate ka vazhduar deri vonë jeta kulturore. Edhe këto, sidomos prej viteve '81 e këndej me shumë vështirësi, po megjithate ja kanë dal. Mu më kujtohet edhe në vitet '90 është bërë një punë shumë e mirë. Edhe në ato kushte të dhunës, të përcjelljes e të terrorit e të gjitha ato. Po nuk është ndaluar si të thuash ajo jetë kulturore, po edhe arsimore kështu.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Nëse mundeni me na tregu për punën kur e keni fillu, në cilat shkolla ose si ju ka shku pastaj jeta profesionale?

Fazli Hajrizi: Po të them sinqerisht unë kam fillue, ju tregova në Skenderaj. Aty kom punu, kom punu edhe ni vit në Viti, në gjimnazin e Vitisë. Të them të drejtën si i ri me entuziazëm dhe me atë entuziazëm e shoh tash kur i shpaloj kujtimet e di që kam bërë mjaft gabime. Gabimi ma i madh që s'kom punu ma shumë edhe s'jom angazhuar më shumë, po duke i parë shokët e mi që ishin ma të vjetër edhe puna e tyre, sjellja e tyre ishte një mësim për mua, një shembull për mua dhe për të tjerët besoj.

Kemi arrit diçka, kryesisht me të than të drejtën nja dhetë vjet a sa i bie kom punuar në fazën e parë, atëherë u quante Qendra Ushqimore e Bazave të Përbashkëta. I kryenin dy vjet e mandej profilizoheshin kush në teknikë, kush në gjimnaz, kush në ekonomi, kush në medicinë. Domethonë, ka qenë ni provë të them të drejtën e Shuvarit, Stipe Shuvar³ dhe ajo u aplikua ose u zbatua së pari kishe në Kosovë dështoj pas dhetë vjetësh dhe u rikthye në gjendjen çfarë ka qenë po në '87 kur u kthye, gjendja ishte këtu në Kosovë sidomos me nji gjendje të keqe.

³ Stipe Shuvar (Zagvozd, afër Imotskit, 17 shkurt 1936 - Zagreb, 29 qershor 2004) ishte një politikan kroat dhe jugosllav. Nga 30 qershor 1988 deri më 17 maj 1989, ai shërbeu si kryetar i Presidiumit të KQ të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Ai u zgjodh anëtar i Kryesisë së RSFJ-së në vitin 1989. Nga 15 maji deri më 24 gusht 1990 shërbeu si nënkryetar i Kryesisë së RSFJ-së.

Po megjithatë vazhdoj deri në '91, ajo periudhë të them sinqerisht sa kam punuar se kam dhënë gjuhë shqipe kryesisht po ndonjiherë kur mungonin profesorë të kualifikuar të gjuhës latine, meqenëse kisha në përvojë edhe një njohuri ma merr mendja të mirë, angazhohesha me një, dy, tri paralele, mendoj jipja edhe gjuhën latine edhe ajo koha ma e ligë si të thuash ka qenë kur filluan ato trysnitë për ndryshimin e plan-programeve mësimore.

Pas demonstratave '81 kur faktikisht Serbia kërkonte që të aprovohejshin ose miratohejshin plan-programet e Ministrisë së Serbisë. Edhe aty tani dihet çka bëhej me Ismail Kadarenë e me Naimin e me plot shkrimtarë që hiqeshin dhe shtoheshin autorë serbë e ku di unë, e të them të drejtën ka qenë e mira që të gjithë kemi qenë në një gojë edhe ja kemi dalë besoj faqebardhë kështu që nuk i pranuan edhe pse u ndëshkuam kështu kuptohet me pasoja.

Jo veç në këtë formën po edhe me largimin sidomos niherë me segregacionin ose ndarjen e nxanësve serbë paradite, mbasdite shqiptarët, helmimi i nxanësve që pasoj. Ka qenë diçka e tmerrshme si të thuash. Edhe ma vonë mospranimi i vulosjes së dëftesave, diplomave. Vendimi i do organeve atje që unë nuk... kam qenë veç mësues, drejtori i dinte këto punë. Me një nënshkrim, në formë të ndryshme pastaj nxanësit tonë pastaj kanë vazhduar edhe janë regjistruar në fakultete të ndryshme e kështu. Pastaj edhe përzënja nga puna.

Madje prej shtatorit deri në shkurt kemi pritur për shembull '91 deri në shkurt '92 kemi pritur po e zëmë deri sa u dha një mundësi që të vazhdohet mësimi sipas variantit C, domethonë në shtëpi-shkollë ose në objekte shkollë të shkollave fillore kështu. Se u larguam prej gjimnazit edhe prej shkollave tjera kuptohet. Madje edhe disa shkollë, po e zëmë "Aziz Sylejmani", "Bedri Gjinë" jo më fal, si thirret ajo "Nonda Bulka" se e ka pas një emër të një serbi edhe ato u ndërprejnë andej urës Ibrit. Mo mjekësia, e teknika e sende, faktikisht u mbyllën, [mbetën] veç për nxanës serbë.

Anita Susuri: Po du paraprakisht me ju pyet edhe se ju keni qenë në "Frang Bardhi" gjimnazin tu dhonë mësim në atë kohë, viti '88-të marshi i minatorëve kur fillon ën nifarë forme me u shfaqë pakënaqësia në mënyrë demonstrative. A ju kujtohet mardhi minatorëve, si ka qenë ajo kohë për juve, se e di që shumë shkollë ju kanë dhënë përkrahje edhe ju kanë bashkangjitur?

Fazli Hajrizi: Po, të them sinqerisht në çdo paralele, në çdo dhomë mësimi kemi pas të paktën dhetë fëmijë që kanë qenë fëmijë të minatorëve. Edhe kutpohet në pak a shumë e dinim çka po ndodhë atje se ishte shtypi, ishte televizioni, ishin plot mjete të informimit që na jipnin për të kuptuar se ç'po ndodh atje edhe ka qenë në mbështetje jo veç prej masës gjërë kështu, po edhe prej shkollave. Ka qenë në guxim i jashtëzakonshëm i njerëzve tonë, mendoj edhe i mësuesve, mendoj edhe i nxanësve kryesive të paraleleve.

Të kuptohet edhe kryesive të klasave që ishin përzgjedhë besoj nxanës ma të mirë dhe bënin peticionin ose bënin kërkesën në mbështetje të kërkesave të minatorëve. Unë besoj që i dini ato cilat kanë qenë disa prej kërkesave të tyre, një më së pari që të rikthehet ose më mirë të themi viti '89 kur u mor subjektiviteti i Kosovës, faktikisht ishte një diçka që u pa se ku po na shpie Sërbia shkurt. Dhe minatorët thjesht ishin ajo barikada si të thuash që këtu duhet me u ndal dhe më tej nuk shkon.

Për arsye se u mbyllën si e dini mbetën tetë ditë brenda në horizontin e dhjetë atje edhe vazhdimisht ishin konsistent si të thuash, ishin të vendosur që ato kërkesa të tyre të miratohen ose të zbatohen, ato kanë qenë sigurisht të artikulume në atë rrethin e tyre dhe kanë qenë mjaft të avansuara në atë kuptim. Edhe ai marshi që ka qenë për shembull, unë për veti i kam parë veç në fotografi se se kom pa atë marshin e tyre atë ditë, po më fotografinë e Titos e sende ka qenë dicka që me i ikë represionit edhe formave të tjera.

E këto veprimtari tjera për shembull tubime në palestrën sportive që e kemi këtu afër e forma tjera ato veq i kemi përcjellë. Në atë kohë të them të drejtën u angazhova, në të vërtetë më mirë të them u angazhuan edhe në kryesinë e Lidhjes Demokratike të Kosovës në degën në Mitrovicë isha kryetar i Komisionit për Informim. Se ka pas disa komisione. Edhe i kom përcjellë kështu me të thon të drejtën edhe dhunën edhe terrorin edhe ndjekjen edhe largimin nga banesat edhe shumëçka tjetër. I përcjellnim në QIK atje, do me thonë në Qendrën Informative të Kosovës.

Kam qenë edhe anëtar në Pajtimin e Gjaqeve, në vitet '90-të, ndoshta nuk kam mund të jem shumë, shumë i pranishëm në ato veprimtari për arsyen se isha i angazhuar edhe në shkollë. Është dashur të lëviz nga punkti në punkt që i kishim pesë a gjashtë dhe dihet ajo ishte puna parësore e imja, kish veprimtarë tjerë që nëse mungoja unë i kryenin ata. Nuk po them se kam bo ndonjë punë të madhe por megjithatë me të thonë të drejtën kom qenë pak a shumë në rrjedha të këtyre ngjarjeve kështu.

Greva minatorëve me të thonë të drejtën ka qenë një prej ngjarjeve më të rëndësishme që në fillim të viteve '90-të, veç dihet u ndamë ose në njëfarë mënyre u nda shapi nga sheqeri. U ndanë rrugët, u krijuan plot mundësi në atë kuptim të një politike me të thonë të drejtën ndoshta në fillim shumë të mençur që t'i iket përplasjeve, sidomos me armë. Edhe pavarësimit të shëndetësisë, pavarësimit të arsimit, besa të sportit e plot fushave të tjera kështu.

Mu më kujtohet po e zamë kur vinin o lojtarët ose trajnerët edhe tregonin se si ka ndërhy policia po e zëmë në ndonji livadh, krejt diku në periferi atje që përpiqeshin ta zhvillonin aktivitetin e tyre sportiv të them sinqerisht me kushtet që i kemi sot dhe me njëfarë neglizhence që ekzistonte te disa njerëz jep me kujtu që ai entuziazëm ka ekzistue dikur të them sinqerisht ka dhënë rezultate të mira, edhe pse në rrethana të jashtëzakonshme kështu.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: A ju kujtohet dita kur ju kanë largu prej shkollës policia që kanë ardh në gjimnaz?

Fazli Hajrizi: Po të them sinqerisht ma përpara drejtoresha Gordana Mikiq u vendosën ato drejtoritë ose drejtorët e dhunshëm si të thuash. Ne kishim Hajzer Mustafën drejtor edhe në atë kohë të them paralajmërohej se duhet bërë këtë, këtë, këtë. Për shembull aprovimin e këtyre plan-programeve që ju thash pak ma herët, ne nuk pranuan. Pastaj ndarjen e nxënësve serbë paradite, shqiptarët pasdite, e plot gjana të tjera edhe mandej, se, “Do të ndëshkoheni edhe me ndalimin e pagesës”, mendoj të rrogës kështu.

Megjithatë ne vazhduam, ishin disa organe që unë nuk kam qenë në to, po megjithatë kanë kry atë funksionin e vet. Si për shembull Sindikata e Pavarur në nivel të gjimnazit, pastaj Pleqësia e shkollës, tash Këshilli i shkollës është me një formulim pak ma ndryshe. Po megjithatë, kanë qenë në nivel besoj të vetëdijes. Në atë kohë më kujtohet kur ata që ishin antarë të Lidhjes Komunistëve ndër ta isha dhe unë kështu edhe plot të tjerë i dorëzuam se nuk pajtohemi me këtë politikë.

Kur me 1 shtator, ju tregova besoj ma herët, me 1 shtator ‘91 ne kërkuam të hyjmë në objektin shkollor, aty veç policia kemi provuar edhe disa herë të tjera. Mandej kemi pushuar. Merrnim udhëzime, jo drejtë për drejtë nga Prishtina por nga drejtoritë tona këtu komunale. Ata na përcjellnin te drejtori, drejtori neve. Edhe vepronim sipas tyre. Edhe kur u pa që s’ka mundësi të kthehemi në objektin tonë. Atëherë kemi hulumtuar të sigurojmë objekte tjera. Domethënë shtëpi-shkolla.

Edhe i gjetëm janë diku mbi dyzet shtëpi, pronarë shtëpish që i kanë lirue për gjimnazin janë tetë, për mjekësinë janë pesë a gjashtë, ekonominë poashtu, medicinën, mandej për shkollën e lartë teknike. Për Fakultetin e Shkencave, jo, Fakulteti Xehëtaro-Metalurgjik. Domethonë kanë punuar kryesisht nëpër objekte private. Por kur e shihnim për shembull kur pak është pushuar dhuna, terrori e çka di unë, edhe ka mundësi për shembull vitet e para dhe të dyta që janë fëmijët pak më të vegjël dhe me moshë më të re i angazhonim për shembull në shkolla fillore në “Skenderbeu” ose në “Migjeni” ose në shkolla tjera, këndej lbrit.

Adea Batusha: E në cilat shtëpi-shkolla keni dhonë ju mësim? A e mban mend ku të ka ra me...

Fazli Hajrizi: Po, kemi filluar në shtëpinë e Azem Sylejmanit në Iliridë ose Tavnik këtu. Në shtëpinë e Hasan Beloshit, ndoshta një periudhë jo të gjatë por disa muaj, në shtëpinë e Fahri dhe Hysen Aliut. Fahriu është vrarë gjatë luftës ‘99. E kom bile ni profil të vogël biografik edhe fotografinë e tij në libër për gjimnazin. Dhe është vra ndoshta edhe për këtë arsye të lutem. Se aty jo veç që kanë punu disa paralele të gjimnazit në ‘92 - ‘93, po aty ka qenë edhe Kryesia e Lidhjes Demokratike.

Aty ka qenë edhe një degë po tash nuk më kujtohet mirë, aty ka qenë profesori Shyqri Kelmendi, profesor në Fakultetin e Xehëtaro-Metalurgjisë që i krynin disa pune administrative në nivel të

fakultetit atje. Ndërsa, ato ligjeratat i mbanin në shkollën fillore “Skenderbeu”. Pastaj ka qenë shtëpia e një Nysret Maxherës, afër stacionit të autobusëve, përballë ka qenë rrugës e një Muharrem Avdiut inxhinjer, ka qenë. Aty...

[Këtu ndërprehet intervista]

Fazli Hajrizi: Ndoshta...

Adela Batusha: A të ka ra ty me ndërru lokacionin gjatë gjithë kohës a qysh është organizu?

Fazli Hajrizi: Po, është interesant kështu, të them sinqerisht kur keqtrajtoheshin edhe arsimtarët edhe nxanësit edhe faktikisht largoheshin edhe mendonim se tash të nesërmen asnjë nxanës nuk do ta kemi aty. Për qudi të Zotit të gjithë asnjë mungesë. Arsimtarët, nxënësit, tash kuptohet për veten time por edhe për të tjerët mjaftonte veç që janë. Edhe i kemi afër, do të thotë i kemi praën. Për mësim pastaj kur qetësoheshim dhe vazhdonim kështu punën.

Po ka qenë me të vërtetë një kohë shumë, shumë, shumë e vështirë. Ne nuk e kishim ndonjë mundësi për shembull për t’ju kundërvënë asaj dhune. Më kujtohet edhe në “Migjen” u morrëm vesh ashtu drejtori na tha, “Sivjet do ta vazhdojmë mësimin me vitet e para dhe të dyta në shkollën ‘Migjeni’, ju lutem edhe ata që janë të paraparë...” për shembull ndërrimin, se ndërrimi i parë edhe i dytë ishte i shkollës fillore. Ndërsa ndërrimi i tretë dhe i katërt ishte me nxanës të vitit të parë dej të katërtën, cikli i ulët fillores me nxanës të vitit parë e dytë të gjimnazit.

Edhe shkuam të gjithë ashtu u morrëm vesh. Domethënë të gjithë nxanësit jemi në shkollë. Erdhi koha, ra zili, për çudi në minutin kur ka ra zili, ama për tre minuta osht rrethu krejt shkolla. Edhe për fat jemi munduar ta ruajmë gjakftohësinë i kemi përcjellë prej dritareve se si po veprojnë dhe çka na pret kuptohet. Edhe ma së pari na kanë çu në katin e tretë atje, a dytë se di veç kryesore kanë kriju dy kordone kështu të policëve. Për fat nxanësit nuk i kanë maltretue. Dhe ne 30 a 40 sa kemi qenë arsimtarë kështu, po ma keq e ka pësuar profesori Muharrem Peci që ka pas kështu lëndime shumë të randa.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Bash për gra deshta me ju pyet a ka pas edhe gra?

Fazli Hajrizi: Edhe femra po, ka qenë Sabile Mripa, ka qenë Ferdane Merovci, ka qenë Sabile Mripa thash, Fllanza Mehmeti e plot arsimtare që ndoshta, nuk po them që janë kursy po për fat nuk kanë pësuar ndonjë lëndim të randë kështu, a vërtetë kanë pas keqtrajtime.

Adela Batusha: Në cilin vit ka ndodh qekjo, qekjo që p’e përmend?

Fazli Hajrizi: Kjo ka ndodhë në vitin '94. I kam të gjitha të shënueme me datë, me vit, në libra, më vjen keq kështu që po i përmend. Po në vitet '90-të i pata hy hartimit të monografisë për gjimnazin edhe e pata kry edhe është botuar në 2014, në të vërtetë 2016. Po mandej kam punu edhe monografinë për shkollën teknike, për shkollën ekonomike, për shkollën e mjekësisë. Ma herët e kisha kry edhe për Normalen ajo është mbyll në '77 kur faktikisht u shndërru në akademi pedagogjike domethënë për pesë shkolla të mesme, pesë libra, që besoj diçka të vogël kam ba po me dashuri të madhe besoj.

Adea Batusha: Çka të ka frymëzu me i shku qeta libra specifikisht?

Fazli Hajrizi: Urdhno? {afrohet për të dëgjuar më mirë}

Adea Batusha: Çka të ka frymëzu ty?

Fazli Hajrizi: Po të them sinqerisht me lanë një gjurmë për ate se si kanë kaluar këto shkolla nëpër këto vite, si janë hap, me çfarë vendimi. Unë kryesisht kam punu në arkiv, qe ku e ke {tregon me gisht përball} përball nesh. Aty kam punu, nuk e kam kalu kohën nëpër kafiteri e nëpër kështu, jam ul pesë orë, gjashtë orë kam shfletu dokumentacionin e secilës shkollë edhe ato kanë qenë burim si të thuash, mbështetje për ta shtru ni tekst monografik për një shkollë, për një isntitucion si të thuash.

Kam përmend emrat e mësimdhënësve, kam përmend emrat e nxanësve që kanë diplomuar, me emër e mbiemër. Me prejardhje për shembull nga kanë ardhë. Sidomos në shkollë të mjekësisë ka pas edhe nga rrethi i Novi Pazarit nga Sjenica, Rozhaja. Vendet tjera prej të gjitha anëve të Kosovës. Se ka qenë vetëm ni shkollë në Prishtinë edhe kjo në Mitrovicë. Bile deri në vitin '62 - '63 ka qenë veç në gjuhën serbo-kroate. Shqip janë hap tek atëherë paralelet në gjuhën shqipe.

Kështu ka qenë edhe me shkollën teknike, domethënë deri në '58 - 9 kur ka ardh profesori Milan Perkaj, ka qenë diku këndej nga Plava e Gucia, ni atdhetar i shkëlqyshëm. Bile hartues, bashkëautor i "Pasqyrës së historisë popullit shqiptar" bashkë me Ali Hadrin. Me ardhjen e tij drejtor në teknikë kanë qenë hap dikun me dhjetra, dhjetra profile të ndryshme; xehëtari e, makineri e, metalurgji e, kimi-teknologji e, komunikacion e plot tjera. Kështu. Më fal që ju ngarkova.

Adea Batusha: Jo, s'ka lidhje. E qysh ja keni bo për ni ditë mësimi gjatë viteve '90-ta, mjete, qysh u konë qajo dhoma ku keni dhonë mësim ju?

Fazli Hajrizi: Ka qenë...

Adea Batusha: Me çka jeni shërby, ku keni mrri me marr diçka?

Fazli Hajrizi: Të them sinqerisht deri sa kemi sigurue për shembull një punkt, se numri shumë i madh i nxanësve, ishte e pamundur të përfshihen, kishte udhëtarë, kemi pas nxanës nga pjesa e Bajgorës andej. Shala për shembull, Barja, Vidishiçi, Tërstena kahmos. Gjenim punkta andej. Këto kur nuk kishin mundësi të përfshiheshin, për shembull ndonji paralele ku fjala vjen une kom shkue edhe kom mbajt mësim gati te stacioni i policisë në atë anë atje lbrit.

Kuptohet me marrveshje me nxënës me një banesë të një nxanësi të mirë, kuptohet. Edhe baba i tij punonte fjala vjen në gjimnaz, gjuhë angleze jepte. Bile ai Bardhi është tash kameraman, televizion RTK, Bardh Bekteshi. Domethonë shkonim në banesën e tij po jo grumbull, po tre-katër vetë ngjiteshim, hynim brenda 20-30 nxanës, konsultoheshim. Unë për veti ju jipja ndonji detyrë, ndonji konsultë, kështu. Se për shembull ora e mësimit me 30 minuta osht e pamundur ti ta rrumbullakësosh edhe të japësh atë që parasheh një plan-program e sende.

Po qëllimi unë ka qenë vazhdimisht me i majt nxanësit afër edhe me ni shpresë se ndoshta mas dy muj, ndoshta ma vonë do të kthehem në objektin tonë, kështu edhe e ushqenim shpresën e sende. Edhe kjo ka qenë shkumësi, nëse e zhvillonim mësimin për shembull, në shkollë fillore për shembull ka qenë sikur përpara në gjimnaz dërrasa e zezë, shkumësi. Naj trekonsh diçka për ata matematikanët ose ndonjë mjet konkretizimi për dikë. Për shembull për mua si gjuhëtarë nuk duhej ndonji gjo.

Të them të drejtën u mbyll mundësia e nxanësve që të pajisen me literature nga biblioteka e qytetit, për shembull këtu s'ka qenë ka qenë ni vend tjetër. Kjo osht vendos ma vonë këtu. Po megjithate nuk kom pritu për shembull unë edhe shokët e mi që ju kemi marr libra prej shpije me qese najlloni ju kemi dhanë, kanë lexu, i kanë shpërnda dhe kështu. Po them jemi mundu diçka të bëjmë. Mjete të konkretizimit ka pas pak se besoj edhe i keni ndëgju, jeni në moshë shumë ma të reja dhe si keni përjetu ato gjana.

Po fjala vjen vinte dikush me ni qese me 20-30 fletore, “Qekaq pata mundësi, urdhnoni” edhe ua shpërndanim nxanësve. Ose, ndonji laps, stilolaps ose ndonji gja tjetër edhe ju jipte nxanësve tonë kështu. Ka pas raste për shembull prej fshati a Koshtovë, a Broboniq andej, veç kur vinte para dere. Dikush ju ka tregu me siguri edhe i shkarkonte drutë aty. “Këto janë për shkollën”, “Qysh me ju kompenzu?”, “Unë i kom pru për juve me na u nxe fëmija”. (emocionohet) Kjo ka qenë, o Zot! Kohë, kohë, se di as vet. Kur e kujtoj nganjher them 100 vjet i kam. Më fal të lutem {i drejtohet kamerës}

Anita Susuri: E a keni pas ndihmë ndoshta edhe prej organizatave të huja ndonjiherë?

Fazli Hajrizi: Ma vonë ato patën ardh kështu edhe ato komuniknin kryesisht me drejtoritë komunale atje. Ndonjiherë vinin në shkollë po ato thjesht i dinin drejtorët ma mirë me të thonë të drejtën si i kanë...

Adea Batusha: A je konë ti i përfshim në organizimin e shtëpive-shkolla?

Fazli Hajrizi: Urdhno?

Adea Batusha: A je konë i përfshim në organizimin e shtëpive-shkolla a veç si mësimdhënës je konë i organizum.

Fazli Hajrizi: Edhe në këtë drejtim kam qenë, jo që më ka angazhu dikush, po vet kisha dëshirë. Për shembull që nuk e përmenda pak përpara pronarin e shtëpisë-shkollë Hazir Kelmendin, babanë e Mensur Kelmendit, ata kanë qenë altruist të vërtetë kështu. Njerëz që e kanë lonë veten keq për të ndihmu tjetrin. Kanë lëshu shtëpinë, kanë ndihmu në forma të ndryshme. Haziri ka punu dikun tash nuk më kujtohet a në Gjermani apo Zvicër po thjesht i ka pas kushtet e mira.

E ka lëshu shtëpinë edhe për atë shoqatën humanitare “Nëna Terezë” aty ka funksionue, ka ndihmu edhe në forma të ndryshme edhe arsimin. Edhe kur e pat ndërtu shtëpinë e re atje gati te Zhabari e di që kam shkue, ashtu na tha drejtori me i rregullu, me i pregadit dhomat e mësimi tri dhoma, tri. Kështu kishin qenë të shtrume, të lyme të rregullume edhe i kemi marr me nxanës. Ata vet i kanë bajt edhe nuk ka qenë afër, ndoshta me kilometër.

Ata farë dërrasash si banka të improvizume i punonte një... ka vdekë sivjet... ja pasna... Kurshumliu. Ai ka qenë një mjeshtër i druve, dritareve çka di unë, edhe na i punonte për mrekulli edhe na jipte falë kështu. I qitnim për shembull, çdo dhomë mësimi ka tri-katër aso dërrasa, ata ulëshin qaty me çanta, qaty... Kështu ka qenë. Më kujtohet me një angazhim të vogël edhe në këtë drejtim se nxanësit kur na shihnin ne që ishim bashkë me ta dhe po punojmë bashkë me ta, sikur mobilizoheshin edhe ata ma shumë kështu.

Adea Batusha: A keni majt shënime, qysh i keni notu nxansat?

Fazli Hajrizi: Po, po, kemi pas ditarin, kemi pas gjithçka. Me të thon drejtën nganjherë për të largue si të thush atë monotoninë, ose në njëfarë mënyre për t'i motivu pak a shumë nxansët kemi mbajt edhe ndonji recital. Sidomos neve gjuhëtarëve na binte të bojmë një gjo të tillë. Më kujtohet për shembull “Amë e bijë” të Vinçenc Prenushit, bile rolin kryesor e ka lujt presidentja, Vjosa Osmani. Ka qenë kështu në nxanëse e mrekullueshme. Pa dyshim prej asaj gjenerate ‘96 deri ‘99 ka qenë ndër ma të mirat kështu. Punëtore, e sjellshme, ambicioze.

Edhe mo prej ‘99-tës se kom pa asnjherë, pos në televizion. Më fal kështu që pe përmeni (qeshë). Bile me të thon të drejtën në gjimnaz e kam dëftesën e saj që unë e kam plotësue, unë s’kam qenë kujdestari, kom dhonë mësim edhe gjuhë latine edhe gjuhë shqipe po vëllau jipte matematikë e kam ende bile osh profesor në gjimnaz edhe këta matematikanët i pritojnë kështu administratës, unë e kisha në shkrim pak ma të mirë. Edhe ua kam plotësue.

Unë nuk e kam ditë për shembull në vitin '90 që ajo do të bëhet nesër presidente e imja edhe e juja e të gjithëve. Po qe, si nxanëse e mirë... Unë për vete ni fjalë që e përdornin shumë shpesh prindërit tonë edhe pleqtë tonë, prindi ka qef me pa prindin e vet ma mirë se e bardha, kështu thoshnin. Edhe ashtu ishte edhe për mësuesin. A keni qenë ndonjeha mësuese ndonjiherë? [i drejtohet bashkëbiseduesëve]

Anita Susuri: Jo.

Fazli Hajrizi: Me të vërtetë me pa një fëmijë që po reflekton mirë e po sillet mirë edhe ka rezultate të mira, të duket diçka ma e mirë s'ban.

Anita Susuri: A i keni bajt ju personalisht ditarët ose këto dokumentet me veti edhe a ka qenë rrezik kjo?

Fazli Hajrizi: Me të thonë të drejtën jo rregullisht diçka prej atyne që kam mbajtur gjatë viteve '90-të po edhe ma herët, po sidomos viteve të '90-ta, për fat të mirë ja kom pas dhënë Muhamet Pirrakut shënimet. Sidomos për pajtimin e gjaqeve edhe ato janë botu, bile osht thirrë në emrin tim se "Shënimet janë marr prej Fazli Hajrizit". Po këto që më kanë mbetur në shtëpi për shembull me do gjana, ato çka kom mujt ndoshta diçka kam arritur me shpëtu po shumica janë djegë bashkë me shtëpinë, bibliotekën e të gjitha. Po plotësohen masandej edhe kështu.

Adea Batusha: Mu ndërlihd edhe pak me këtë aspektin logjistik, duke pas me shku prej shkollës në shkollë qysh ja keni bo, qysh jeni marr vesh?

Fazli Hajrizi: Orarin e kemi pas, orarin e kemi pas në qendër. Për shembull në shtëpinë e Azem Sylejmanit, drejtori e ka pas në kthinë të vogël, në vend shumë të thjeshtë atje, në muri i varur orari, aty ditarët e nxanësve kuptohet kanë qenë në fillim do fletore kështu, po në rregull kanë qenë po në imitim i në ditarit. E ma vonë kanë ardh ato ditarët. Aty i kemi lanë edhe pse disa kanë qenë kogja në largësi njana me tjetrën.

Po megjithatë aty i kemi, i kemi përcjellë nxansit kështu për punën për angazhimin, besa për vijimin. Na prekte shumë kur dëgjonim se mungonte një fëmijë tri ditë, katër ditë ose në java dhe kujdestari ma vonë na kumtonte ose edhe unë kumtoja që filan fëmija ka shku në Suedi ose në Gjermani edhe kjo na prekte shumë me thanë të drejtën se fillun edhe me u shpeshtue shkumjet. Po megjithatë ata të vitit të katërt, sidomos në vitin '91, disa me thonë të drejtën është dasht shumë shumë ti kemi në kujdes të madh për arsye se i kërkonin për ti çu në shërbim ushtarak. Dhe kjo ka qenë në sfidë e madhe.

Edhe në këtë drejtim me thonë të drejtën ja kemi dal përveq një djali, përveq një djali me mbiemrin Kaçamaku nëse s'gabo, që e morën me dhunë edhe atje është plagos edhe sot ka pasoja. E ma në atë kohë vinin edhe ushtarë të vdekur, e dini besoj kështu keni dëgju. Po në këtë mënyrë vepronin për shembull, në këtë kohë. Kemi pas drejtorin, kemi pas pleqësinë, jemi mundu me ni fjalë ato organet që

kanë ekzistue atje mendoj ma herët, ti bartim edhe në këtë kohë, bile ndoshta kemi punuar ma me përkushtim.

Adea Batusha: Ku u kanë qekjo qendra që e keni bo ndërrimin e ditarëve, në cilin objekt u kanë qekjo?

Fazli Hajrizi: Në “Azem Sylejmani” ka qenë në Iliridë, këtu në Tavnik. Edhe desha të them në atë kohë, mendoj në vitet ‘90-të kryesisht në fillim të viteve ‘90-të, ka qenë një përpjekje që prapë me u kthye në objekt shkollor. Në fillim drejtori me kryetarin e pleqësisë ose dikë tjetër shkonin për të bisedu atje me drejtorin e sende. Disa herë na tregonin se nuk i kanë prague, plus kur i kanë paralajmërue se do të shkojnë ata e kanë thirrë dikë prej sekretariatit të punëve të brendshme, mendoj policët serbë nuk i kanë leju me hy brenda edhe kështu.

Anita Susuri: A ka pas naj objekt shkollës mesme që ka mbet hap a asnjona, krejt jonë mshelë?

Fazli Hajrizi: Gjatë viteve ‘90-të, për shembull në gjimnaz në katin e dytë kanë punuar nja pesë paralele në gjuhën serbo-kroate, se s’ka pas, pak nxënës. Krejt dhomat tjera kanë qenë të lira. Domethonë gjatë gjithë kohës tetë vjet a nontë sa po i bie objekti i gjimnazit ka qenë i zbrazët thuja. Ata e kanë shfrytëzu për një ndërrim edhe... Po kështu edhe me shkollën e mesme të mjekësisë, ka qenë ja këtu përtej lbrit, edhe ajo faktikisht ka qenë me një numër të kufizum me paralele në gjuhën serbe se me të thonë sinqerisht edhe në paralele serbe ka pas shumë pak serbë.

Kryesisht kanë qenë boshnjakë, ka pas romë e kështu, pak ka pas serbë. Po kështu edhe në shkollën teknike që e kanë objektin ndër ma të mirët ka qenë atëherë në Jugosllavi, ish Jugosllavi. Me punëtori në podume, që nuk ja gjen shoqen dikun. Jo veç në Kosovë po në krejt shtetin atëherë të ish Jugosllavisë. Bile ka qenë shembull kështu për ish shtetin si shkolla ma e avansume. Këtu e ka kry teknikën edhe Mahmut Bakalli, (qesh) nëse kështu ju intereson me ditë.

E kështu. Domethënë ka qenë edhe shkolla, cila harrova, ekonomia që është ngjit me gjimnazin. Bile ekonomia ka qenë dikur me Normalen, pjesë e gjimnazit. Domethënë me drejtorinë e gjimnazit edhe mandej ‘67 - ‘68 janë pavarësue edhe janë kriju shkolla në vete. Gjimnazi u ndërtu në një objekt të ri, ekonomia ka kalue masi osht shue Normalja në objekt Normales. E ka trashëgu mandej edhe emrin ose emërtimin “Hasan Prishtina” e kështu.

Anita Susuri: Deri kur kanë vazhdu këto shkollat, po mendoj ‘99-tën, kur kanë fillu bombardimet apo...?

Fazli Hajrizi: Pak ma herët, 14 mars, ra një granatë prej një pjesë andej {tregon me gisht përballë} në lartësi. Tash prej ku është lansu nuk e dimë po kryesore ka ra në treg. Edhe për çudi të Zotit atë ditë në treg po thuja nuk ka qenë as një serb, askush tjetër, po mendoj prej tyre, se si duket kanë qenë edhe të paralajmërun. Edhe aty pësojnë me dhjetra, dhjetra edhe vdesin, disa plagosen.

Ne e dëgjuam si rast edhe më kujtohet si sot kemi ecë kështu edhe kemi shkue për me dhonë si lajm kështu edhe pse kemi bashkëpunu në një zyre të vogël, kemi qenë në një dhomë të kufizume me një faks me ni diçka të vogël, me atë kryetarin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, këtë Halil Baranin. Bashkë kemi punu një tetë vjet kështu shumë i gjallë ai njeri, o Zot! Kah i merrte informacionet nuk e di po mu më ka ndihmu shumë po edhe veten edhe tjerëve kështu.

Edhe kështu, kështu ka ndodh, e di që e kam thirrë drejtorin masi kom shku në shtëpi se atëherë nuk kemi pas telefona të xhepit e sende po fiks. Tha, “Po” tha, “jam i njoftum, e dimë. Veç po e pres” tha “përgjigjen prej Drejtorisë Komunale të Arsimit, e ata do të lidhen me Prishtinën”. Edhe mas një ni ore na u njoftum se mesimi ndërprehet. Kështu që me 24 [mars] pastaj dihet ndodhën bombardimet e ne e kemi ndërpre me 14 [mars]. E kështu.

Anita Susuri: E gjatë bombardimeve keni qenë në Mitrovicë apo në fshat?

Fazli Hajrizi: Këtu kam qenë deri 12 ditë para se me kapitullu Sërbia. Herë në periferi, herë brenda në qytet tu lëviz. Edhe ma vonë kom kalu në Ulqin, shkonin do autobusa, tamam u rahatova pak, shpëtuam se faktikisht Sërbia kapitulloi. Edhe në hovin e parë që vinin autobusët këndeje kam ardh, kam jetu një ni mot-mot te vëllau se shtëpia u dogj edhe tani kadal-dal u qetësum edhe vazhdum një jetë të re në liri, që u përpoqëm në forma ndryshme ta ndërtojmë edhe lirinë. Edhe shtetin. Besoj është bo mjaft, jo mjaft po diçka është bo po do të duhej ma shumë. Do të duhej ma shumë po kaq kemi pas kaqik (buzëqeshë) edhe...

Anita Susuri: Po më intereson edhe nëse mundeni me na tregu për përvojën e luftës, si e keni përjetu ju?

Fazli Hajrizi: Urdhno?

Anita Susuri: Përvojën e luftës, si ka qenë për juve? Thatë që keni udhëtu shumë mrena qytetit edhe në Mitrovicë ka qenë koga rëndë. Si ka qenë koha luftës për juve?

Fazli Hajrizi: Koha e luftës? Po e randë shumë. E randë shumë.

Anita Susuri: Po mendoj gjatë bombardimeve.

Fazli Hajrizi: Gjatë bombardimeve të them të drejtën atë nate e kam përjetu në periferi të qytetit atje në maje të Zhabarit është një fshat, në një shtëpi gati të skajshme afër malit, me familje edhe dy-tri familje të tjera, u ngujum. I shihnim ato dritat kur edhe caqet ku qëllojshin, Në momentin kur është qëllue kjo kazërma këtu afër Mitrovicës, afër gjimnazit sipër, ma nalt, ka pas shkundje të mëdha, xhamat kanë ra sipër. Bile djalit e kisha afër kështu edhe për fat shpëtoj se u coptuan xhamat krejt.

Edhe u gëzuam shumë se shpëtuam po ai zgjati edhe 78 ditë, a po? Se kaniherë po i harroj do gjana kështu (qeshë). 78 ditë zgjati kjo deri sa thjesht u pa se edhe Millosi edhe qeveria e tij kanë mendu që hajgare osht tu bo NATO-ja edhe nuk e kanë përnime Bashkësia Ndërkombëtare. Ose kanë qenë si të thuash nën trysnin e Ruisë me mat pulsën e NATO-s, se vërtet a mund t'ia dalin. Edhe fundi-fundit kështu. Mos po hezitojnë ndonjëra prej këtyre shteteve që janë të reshtuara në NATO.

Për shembull, e kishin fjalën për Spanjën ose për Greqinë ose për Holandën ose Luksemburgun ose cilat kanë qenë Belgjika e sende anëtare të NATO-s. E sa për Shqipërinë që nuk ka qenë anëtare faktikisht ka qenë shtet ndihmës, se aty ka pas baza. Ose Italia fjala vjen, e sende. Po kryesore ja dolën edhe shpëtuam. E tash ajo çka është brenga ma e madhe është se po ka zbrazje. Kështu që po të vepronim e të dinim të punonim pak ma mirë fill pas luftës për të bërë diçka që fëmijtë tanë, të rinjtë tanë këtu të sistemohen, këtu të jetojnë, këtu të kontribojnë.

Pavarësisht që ka pas mundësi për shembull me vazhdue shkollimin qysh e kanë vazhdue tash edhe e vazhdojnë edhe nesër me u rikthye sërish si kuadro të kualifikuara, sikur nuk kemi pas ndonji rezultat të mirë në këtë drejtim. Po megjithatë e mira është që ata kudo që janë ata janë tanët edhe reflektojnë kudo që janë mirë, besoj. Edhe me sjellje, edhe me punë edhe me shumëçka tjetër. Edhe unë për vetë kudo që ndëgjoj që ata kanë rezultate ju gëzohem për arsyen se thjesht janë tanët kështu, edhe bajnë një punë të mirë për njerëzimin. E në mënyrë indirekte edhe për kombin tonë e kështu.

Anita Susuri: Zoti Fazli falemnderit shumë edhe për kontributin e juv edhe për intervistën, për kohë!

Fazli Hajrizi: Me nder qofshi! Edhe më keni kthi në një kohë edhe pak (buzëqeshë)...

Anita Susuri: Ju kemi emocionu pak (qeshë)

Fazli Hajrizi: Edhe përbrenda njeriu është i shkapërderdhur në atë kuptimin kur i kujton do gjëra.